



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Gjendjen Civile.
2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs

KONCEPT DOKUMENTI PËR GJENDJEN CIVILE

Përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme

Agjencia e Regjistrimit Civil

Dhjetor, 2021

PËRMBAJTJA

Përmbledhje e koncept dokumentit.....	3
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	5
HYRJE	6
KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	8
Problemi kryesor	21
KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT	26
KAPITULLI 3: OPSIONET	27
Kapitulli 3.1: Opsioni status quo (nuk ka ndryshim)	27
Kapitulli 3.2: Rishikimi i politikave ekzistuese	27
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë - Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit përmes ndryshimeve legjislativë (i rekomanduar)	28
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	31
Kategoritë e ndikimeve	31
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	32
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	33
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	35
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	38
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik.....	39
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	42
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	46
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore	48

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept dokument për Gjendjen Civile
Ministria bartëse	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil
Personi kontaktues	Erdon Arifaj Zëvendësues i Drejtorit të Drejtoratit të Gjendjes Civile 038-200-19-226
PSO	2.4.11. - Zgjerimi dhe modernizimi i shërbimeve në Agjencinë e Regjistrimit Civil
Prioriteti strategjik	Rritja dhe ruajtja e sigurisë publike

Vendimi	
Çështja kryesore	Në bazë të analizës së gjendjes aktuale, çështja kryesore është avancimi i shpërndarjes dhe shkëmbimi i të dhënave dhe shërbimeve të gjendjes civile, si dhe harmonizimi i legjislacionit aktual me <i>acqui</i> të BE-së, si dhe përshtatja me dinamikat dhe trendet e reja në fushën e gjendjes civile.
Përmbledhje e konsultimeve	Konsultimi paraprak për Koncept Dokumentin për Gjendjen Civile është zhvilluar në muajin nëntor 2021. Konsultimi publik përmes platformës për konsultime publike është zhvilluar gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2021.
Opsioni i propozuar	Opsioni i shqyrtuar dhe i rekomanduar është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative - Opsioni 3 .

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor.
Ndikimet ekonomike	Si parim, me hartim të Ligjit të ri për Gjendjen Civile nuk do të ketë ndikime të mëdha ekonomike. Ndikimet ekonomike që do të pasojnë nga ligji i ri, do të jenë pozitive.
Ndikimet shoqërore	Ndikimet shoqërore me hartimin e ri të Ligjit për Gjendjen Civile do të jenë të theksuar, në aspektin pozitiv sepse do të lehtësojnë qasjen dhe shërbimin për qytetarët në përgjithësi.

Ndikimet mjedisore	Në përgjithësi, opsioni i propozuar nuk do të ketë ndikim të madh mjedisor, me përjashtim të digjitalizimit të sistemit, i cili do të ketë ndikim pozitiv për nga konsumi më i vogël i letrës.
Ndikimet ndër-sektoriale	Masat e propozuara pritet të kenë ndikime ndër-sektoriale, sepse Koncept Dokumenti parasheh që me miratim të Ligjit të ri do të ketë një bashkëpunim më të theksuar ndërmjet institucioneve relevante.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta.
Testi i NVM-ve	Nuk është aplikuar testi i NVM-së.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i ligjit të ri për gjendjen civile.
Afatmesëm	Hartimi i legjislacionit sekondar me ligjin e miratuar. Avancimi dhe ndërlidhja e databazave, si dhe zbatimi i masave që janë paraparë në zbatimin e opsionit të preferuar.

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
RQGJC	Regjistri Qendror i Gjendjes Civile
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept dokumenti për Gjendjen Civile
Ministria bartëse	Ministria e Punëve të Brendshme Agjencia e Regjistrimit Civil
Personi kontaktues	Erdon Arifaj Zëvendësues i Drejtorit të Drejtoratit të Gjendjes Civile 038-200-19-226
PSO	2.4.11. - Zgjerimi dhe modernizimi i shërbimeve në Agjencinë e Regjistrimit Civil
Prioriteti strategjik	Rritja dhe ruajtja e sigurisë publike
Grupi punues	<ol style="list-style-type: none"> 1. Erdon Arifaj / ARC- Kryesues; 2. Qendrim Bytyqi – DIEKP/MPB - Zëvendës kryesues; 3. Meliza Qorraj – Departamenti Ligjor / MPB -Anëtare; 4. Shkodran Manaj – ARC / MPB -Anëtar; 5. Drita Xheladini - DBF / MPB -Anëtare; 6. Ariana Podrimaj ZIP / MPB -Anëtare; 7. Venera Dibra NJMBNJ / MPB -Anëtare; 8. Marigona Ramaj - DIEKEP/ MPB -Anëtare; 9. Lorik Lipoveci – Kabineti Ministrit / MPB -Anëtar; 10. Genc Hamzaj - ARC/ MPB -Anëtar; 11. Jeton Sadriu – ARC/ MPB -Anëtar; 12. Safet Osmani – ARC / MPB -Anëtar; 13. Liridon Neziri – DSHAM / MPB -Anëtar; 14. Drita Hasani – DSHP / MPB –Anëtare; 15. Muhamet Berisha – PK / MPB -Anëtar; 16. Arta Maxhuni – MPFT – Anëtare; 17. Vlorë Dobraj – MPJD – Anëtare; 18. Habit Hajredini – ZQM / ZKM – Anëtar; 19. Valon Hetemi – ZKM – Anëtar; 20. Zenel Hisenaj – MSH – Anëtar; 21. Valdete Navakazi – ASK – Anëtare; 22. Përfaqësues i MD-së; 23. Përfaqësuesi i AKK-së; 24. Drita Perezic – ICITAP – Anëtare e Jashtme; 25. Isa Maloku – ICITAP – Anëtar i Jashtëm; 26. Arbër Nuhiu – CSGD – Anëtar i Jashtëm; 27. Milanka Bazdar – UNHCR – Anëtare e Jashtme; 28. Mentor Seferi – CRPK / UNHCR – Anëtar i Jashtëm; 29. Valbona Boshtrakaj – Zyra e BE-së – Anëtare e Jashtme;

	<p>30. Fernando Barrierero Cacho – Zyra e BE-së – Anëtar i Jashtëm; 31. Vena Neivergelt – Zyra e BE-së – Anëtare e Jashtme; 32. Blert Morina – CEL – Anëtar i Jashtëm.</p>
--	--

KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Gjendja civile është tërësia e të dhënave personale të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, të cilat regjistrohen dhe mbahen në regjistrin e gjendjes civile dhe që vërtetojnë lindjen, statusin familjar, vdekjen, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe çdo ndryshim që ndodh në këto marrëdhënie.

Gjendja civile, konkretisht regjistrimi civil luan një rol tejet të rëndësishëm për të gjithë individët (qytetarët), duke filluar nga e drejta për të regjistruar lindje, vdekje, martesë dhe çdo ngjarje tjetër të ngjashme jetësore, si dhe shkaqet e regjistrimit të vdekjes. Për më tepër, gjendja civile krijon mundësinë që qytetarët të pajisen me forma ligjore të identifikimit, duke u mundësuar kështu qasjen në çdo shërbim. Gjithashtu gjendja civile nënkupton një njohje të përgjegjësive të shtetit ndaj një individi. Regjistrimi i lindjeve dhe vdekjeve, u mundëson individëve dhe familjeve të tyre qasjen në burimet dhe disa prej të drejtave themelore. Regjistrimi civil është pjesë e të drejtave civile të qytetarëve, që merret me regjistrimin e të dhënave të qytetarëve dhe personalizimin e tyre në dokumente personale, si dhe mirëmbajtjen e tyre nga institucionet e shtetit të përcaktuar me ligj. Regjistrimi civil është emër i përbashkët i regjistrimit të fakteve jetësore, regjistrimi i lindjes, regjistrimi i shtetësisë, martesës, kurorës, lindjes së fëmijëve dhe të ngjashme. Me fjalë të tjera, regjistrimi civil është shënimi (shkrimi) i të gjitha fakteve biologjike dhe jetësore të njerëzve nga shteti në të cilin ndodhin këto fakte në regjistrat të cilët i krijon shteti.

Duke iu referuar Raportit të Vlerësimit për Agjencinë e Regjistrimit Civil (tani e tutje “ARC”) në Kosovë prej periudhës 24 nëntor 2015, “ARC-ja në periudhën 2011-2015 ka zbatuar përmirësime të rëndësishme në Sistemin e Regjistrimit të Gjendjes Civile, Sistemin e Regjistrimit të Automjeteve, si dhe Ministria e Punëve të Brendshme (tani e tutje “MPB”) ka krijuar dokumentet biometrike të identifikimit. Sistemet për identifikimin e dokumenteve, regjistrimin e automjeteve, proceset për aplikimin dhe shpërndarjen e dokumenteve të identifikimit dhe patentë shoferëve janë drejtpërdrejt të lidhura me Sistemin për Regjistrimin e Gjendjes Civile si të dhëna burimore kryesore për aplikimin e dokumenteve.”

Regjistri Qendror i Gjendjes Civile (tani e tutje “RQGJC-“) është themeluar me bazën qendrore me 19 shkurt 2013, prej nga dokumente të ndryshme të gjendjes civile janë shtypur në bazë të dhënave të RQGJC-së.

Tendenca globale tregon një evolucion të vazhdueshëm në teknologji për analizimin, shfrytëzimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave. Ky evolucion i shpejtë teknologjik bën të mundur krijimin e shërbimeve dhe aplikacioneve të reja, të cilat janë ndërtuar për përdorimin, grumbullimin ose kombinimin e të dhënave. Shkalla e grumbullimit dhe shkëmbimit të dhënave

personale është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Teknologjia e bën të mundur që kompanitë private si dhe ato publike të përdorin të dhëna personale për të kryer aktivitete të tyre. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet niveli i lartë i sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 dhe Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021, gjithashtu përcaktojnë objektiva në fushën e përmirësimit të shërbimeve për qytetarët, nëpërmjet përmirësimit të e-qeverisjes dhe shërbimeve elektronike.

Shërbimet lidhur me gjendjen civile kryhen nga Zyra e Gjendjes Civile (tani e tutje “ZGJC”), ata janë përgjegjëse për lëshimin e numrave identifikues personal, certifikatat e lindjes, familjes, martesës dhe vdekjes në mënyrën e parashikuar me ligj, ata kryejnë veprime të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin për Gjendjen Civile dhe aktet nënligjore në fuqi.

Për më tepër, edhe shërbimi i Gjendjes Civile në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës menaxhon dokumentacionin dhe kryen transaksione në Regjistrin e Gjendjes Civile për shtetasit e Kosovës me vendbanim të përhershëm jashtë vendit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe dispozita të tjera përkatëse ligjore.

ARC-ja ju ofron qytetarëve certifikata zyrtare kur ata duhet të identifikohen. Ekziston një numër i akteve ligjore në Kosovë që rregullojnë dokumentet e identifikimit, pasaportat, regjistrimin e gjendjes civile (lindjen, martesën, vdekjen etj.), regjistrimin e automjeteve, politikat e patentë shoferëve dhe gjithashtu ekzistojnë aktet ligjore që rregullojnë statusin e ARC-së, funksionet, përgjegjësitë, si dhe arkivimin e dokumenteve.

Pika kryesore është se aktet ligjore në aktivitetet e ARC-së nuk sigurojnë zgjidhje për lëshimin e dokumenteve duke përdorur teknologjinë e cila përjashton përdorimin e letrës. Sidomos udhëzimet administrative dhe rregulloret nuk ndjekin parimin e minimizimit të certifikatave të ndryshme ose ekstrakteve dhe dosjeve të letrës.

Korniza institucionale dhe legislative e gjendjes civile në Republikën e Kosovës

Gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, Ministria Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Regjistrimit Civil ka marrë parasysh një numër të instrumenteve dhe parimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushën e gjendjes civile.

Në tabelën e mëposhtme identifikohen ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me çështjen që trajton ky Koncept Dokument. Po ashtu precizohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre akteve, si dhe roli dhe detyrat e institucioneve zbatuese të ligjit.

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2743	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky ligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.
Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2570	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky ligj e rregullon kuptimin, përbërjen, procedurën dhe mënyrën e caktimit dhe të përdorimit

			të emrit personal, si dhe kushtet për, ndryshimin dhe korrigjimin e tij për qytetarët e Kosovës (në vazhdim të tekstit: qytetarët).
Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530	Komunat	Ky ligj themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.
Udhëzim Administrativ Nr. 20/2012 -MPB për Kushtet dhe Procedurat për Dhënien e Provimit Profesional për Zyrtarët e Gjendjes Civile	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8166	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen dhe rregullohen kushtet dhe procedurat për dhënien e provimit profesional për zyrtarët e gjendjes civile.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 18/2013 për Regjistrat Themeltarë të Gjendjes Civile Dhe Regjistrat E Veçantë	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10115	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen llojet, forma, përmbajtja, futja e të dhënave, si

			dhe mënyra dhe afati i mbajtjes së regjistrave themeltarë dhe të veçantë të gjendjes civile.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 11/2017 për Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15648	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i mënyrës së krijimit, administrimit, përmbajtjes, regjistrimit, përditësimit të të dhënave të gjendjes civile, si dhe rregullat për shfrytëzimin e teknologjisë informative që do të përdoren për përdorimin e Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr.25/2013 për Dokumentet e Gjendjes Civile	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10169	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky udhëzim administrativ përcakton llojet, format, elementet përbërëse, mënyrën e mbajtjes, afatin e përdorimit të dokumenteve që mbahen dhe lëshohen

			nga shërbimi i gjendjes civile dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve.
Udhëzim Administrativ Nr. 05/2012 – MPB për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8118	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi dhe rregullimi i procedurave të punës së Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve lidhur me dokumentet e lëshuara nga organi komunal i gjendjes civile, si dhe përbërja dhe përcaktimi i përgjegjësive të komisionit.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 06/2016 për Numrin Personal	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12653	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kriteret dhe procedurat e lëshimit të numrit personal për shtetasit e Republikës së Kosovës, personat që e rifitojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës,

			shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 08/2015 për Riregjistrim në Regjistrat Themeltarë të Gjendjes Civile	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10837	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky udhëzim administrativ përcakton kriteret, dhe procedurat për riregjistrimin e lindjeve, martesave, dhe/ose vdekjeve në regjistrat themeltar të gjendjes civile në Republikën e Kosovës, në rastet kur regjistrat themeltar janë humbur, dëmtuar ose shkatërruar.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 24/2015 për Regjistrimin e Mëvonshëm në Regjistrat e Gjendjes Civile	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11321	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky udhëzim administrativ përcakton dhe rregullon kriteret, format dhe procedurat për regjistrimin e mëvonshëm të lindjeve dhe vdekjeve për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e

			huaj, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, të cilat kanë ndodhur brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës e që nuk janë regjistruar në regjistrat e gjendjes civile brenda afatit ligjor.
Udhëzim Administrativ Nr. 03/2013 – MPB për Vulën Verifikuese	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9880	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky udhëzim administrativ përcakton formën dhe përmbajtjen e vulës verifikuese si dhe rregullon procedurat e aplikimit dhe verifikimit, në dokumentet e Gjendjes Civile dhe Regjistrimit Civil për përdorim jashtë vendit.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 11/2018 për Përdorimin e Kopjeve të Certifikuara të Regjistrave Origjinal Themeltar	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18327	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i procedurave për përdorimin e

<p>të Gjendjes Civile të Kosovës, të cilët janë marrë nga ish-pushteti serb, para qershorit të vitit 1999</p>			<p>kopjeve të certifikuara të regjistruara themeltar origjinal të gjendjes civile të Kosovës, të cilët janë marrë nga shërbimet amë të gjendjes civile në Kosovë, nga ish pushteti serb para qershorit të vitit 1999.</p>
<p>Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11168</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil</p>	<p>Ky udhëzim administrativ përcakton dhe rregullon kriteret dhe procedurat për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal për shtetasit e Republikës së Kosovës.</p>
<p>Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 12/2018 për Kushtet dhe Procedurat e Dhënies së Provimit Profesional për Zyrtarë të Gjendjes Civile</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18412</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil</p>	<p>Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen dhe rregullohen kushtet dhe procedurat e dhënies së provimit profesional për zyrtarët që do të ofrojnë shërbime të gjendjes civile.</p>

<p>Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 17/2015 për Procedurën e Përgjithshme të Regjistrimit të Faktit të Lindjes, Martesës dhe Vdekjes</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11020</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil</p>	<p>Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet procedura e përgjithshme e regjistrimit të lindjes, martesës dhe vdekjes, të shtetasve të Republikës së Kosovës të ndodhur në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi të cilët e fitojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës apo personave të huaj me qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm që realizojnë të drejtën e shërbimeve të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.</p>
<p>Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 12/2016 për Përcaktimin e Procedurës së Digjitalizimit të Regjistrave Themeltarë të</p>	<p>https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12900</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil</p>	<p>Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen procedurat e digjitalizimit të Regjistrave Themeltarë të</p>

Skanuar të Gjendjes Civile			Skanuar të Gjendjes Civile, për krijimin e Arkivit Elektronik të Regjistrave Themeltarë të Gjendjes Civile.
Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11168	Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Regjistrimit Civil	Ky udhëzim administrativ përcakton dhe rregullon kriteret dhe procedurat për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal për shtetasit e Republikës së Kosovës.

Politika aktuale dhe përgjegjësitë

Tani, Ligji Nr. 04L-003 për Gjendjen Civile përcakton kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcakton rregullat për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

MPB-ja është përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin, organizimin, mbikëqyrjen e lëshimit të letërnjoftimeve dhe pasaportave, si dhe për politikën e regjistrimit të gjendjes civile në nivelin qendror, i cili është përgjegjës për RQGJC-në, që përmban informacionin e gjendjes civile për të gjithë banorët e Kosovës, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me vendbanim të përkohshëm ose të përhershëm në Kosovë, si dhe për shtetasit e huaj që kanë marrë azil në Kosovë. ARC-ja është një agjenci unike e shërbimit shtetëror. Ajo mban, përditëson dhe menaxhon RQGJC-në, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata dhe kryen shërbime të tjera në përputhje me ligjin në fuqi.

Ligji Nr. 04L-003 për Gjendjen Civile përcakton kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Korniza e Interoperabilitetit e Republikës së Kosovës bazohet tërësisht në Strategjinë e Qeverisjes Elektronike 2009-2015 dhe në Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie. Kjo kornizë bazohet gjithashtu në dokumente të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me administratën publike, sidomos Kornizën Evropiane të Interoperabilitetit.

Ligji Nr. 04 / I-003 "Për Gjendjen Civile " rregullon përdorimin e të dhënave të mbledhura dhe të regjistruara të gjendjes civile. Paragrafi 4 i nenit 3 përcakton se të dhënat e mbledhura dhe të regjistruara për gjendjen civile do të përdoren vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas nenit 6 të këtij ligji, "institucionet e tjera shtetërore dhe private që grumbullojnë dhe administrojnë bazat e të dhënave të personave që përmbajnë të dhëna në lidhje me gjendjen civile, duhet të sigurojnë të dhënat në fjalë në bazë të kërkesës së ARC-së dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ". ARC-ja përdor të dhënat e ofruara sipas dispozitave të këtij neni, për sa kohë që është e nevojshme për të verifikuar dhe siguruar saktësinë e të dhënave të RQGJC-së.

Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr.11 / 2017 Për RQGJC-në përcakton se qasja në Regjistrin Qendror u mundësohet të gjithë zyrtarëve brenda rrjetit qeveritar ose një rrjeti virtual të menaxhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

ARC-ja ka më shumë se 50 marrëveshje për furnizimin e të dhënave për institucionet e tjera qeveritare. Ky proces bazohet në një procedurë standarde nëpërmjet një shërbimi të thjeshtë në internet: pyetje-përgjigje ose periodike (2-3 herë në vit) duke i kopjuar grupet e të dhënave nga marrësi.

Nga pikëpamja organizative, teknike dhe teknologjike, ARC-ja nuk mund të sigurojë zbatimin e plotë të shërbimeve elektronike për qytetarët dhe biznese nëse nuk janë të lidhur me rrjetin qeveritar ose rrjetin virtual të menaxhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Ligji për Gjendjen Civile si dhe aktet nënligjore përkatëse janë të avancuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Gjatë zbatimit të teknologjive që përjashton përdorimin e letrës, vëmendja duhet t'i kushtohet në:

- Parimet e përgjithshme për ndryshimin e akteve ligjore lidhur me zbatimin e teknologjisë që përjashton përdorimin e letrës në ARC;
- Sa i përket harmonizimit të akteve ligjore, duhet të bëhet një propozim për të përgatitur një ligj të veçantë për menaxhimin e burimeve të informacionit. Një ligj të tillë që rregullon menaxhimin e burimeve të informacionit shtetëror:
 1. Llojet e burimeve të informacionit shtetëror;
 2. Formimin dhe zbatimin e politikës së burimeve të informacionit shtetëror;
 3. Aktivitetet e autoritetit për menaxhimin e burimeve të informacionit shtetëror dhe personave të autorizuar për menaxhimin e të dhënave;

4. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesve të regjistrave dhe sistemeve shtetërore të informacionit, mbajtësve të regjistrave dhe sistemeve të informacionit shtetëror, personave fizik dhe juridik që japin të dhëna, informacione, dokumente dhe / ose kopje të tyre dhe që i pranojnë nga regjistrat dhe sistemet e informacionit shtetëror;
5. Parimet kryesore për krijimin dhe menaxhimin e burimeve të informacionit shtetëror;
6. Planifikimin e krijimit dhe menaxhimit të burimeve të informacionit shtetërorë;
7. Platformën e ndërveprimit të burimeve të informacionit shtetërorë;
8. Vlerësimin e menaxhimit dhe mbrojtjes së mjeteve të teknologjisë informative të përdorura për përpunimin e informacionit të menaxhuar nga institucioni gjatë kryerjes së funksioneve të veta statutore;
9. Financimin e shpenzimeve të krijuara gjatë krijimit, menaxhimit dhe mbikëqyrjes së burimeve të informacionit shtetërorë. Ky ligj zbatohet për institucionet shtetërore, agjencitë shtetërore, ndërmarrjet shtetërore, organet publike, të cilat vendosin, krijojnë dhe / ose menaxhojnë regjistrat shtetërorë (kadastra), regjistrat e departamenteve, sistemet e informacionit shtetëror dhe sistemet e tjera të informacionit që financohen nga buxheti i shtetit.

Një çështje tjetër është harmonizimi i dispozitave sanksionuese të Ligjit aktual për Gjendjen Civile me dispozitat e legjislacionit të BE-së.

Përvoja nga vende tjera

Sipas përvojës së BE-së, të dhënat e regjistrimit civil duhet të përdoren nga të gjitha administratat e Kosovës sipas parimit "regjistrohu një herë - përdor shumëfish informacionin". Legjislacioni aktual i Kosovës kërkon që qytetarët të paraqesin një certifikatë në vend të (kopjes) së dokumentit të identifikimit për institucionet (universitetet, shkollat, gjykatat, etj.). Kjo e pengon përparimin e bërë në regjistrimin e gjendjes civile dhe i ngarkon qytetarët.

Sa i përket vendeve të BE-së, Holanda dhe Lituania kanë përvojë të mirë dhe bazë ligjore të zhvilluar mirë për administrimin e të dhënave të gjendjes civile. Ligji për Gjendjen Civile të Republikës së Kosovës përcakton që të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga zyrtari i Zyrës së Gjendjes Civile në mënyrën dhe formën e përcaktuar me Ligjin për Gjendjen Civile dhe aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij. Sidoqoftë, përvoja e vendeve të BE-së tregon se të gjitha të dhënat në RQGJC duhet të njihen si të sakta dhe të plota nga momenti i regjistrimit të tyre në Regjistër, nëse nuk janë të pavlefshme në mënyrën e përcaktuar me ligje. Gjëja më e rëndësishme është momenti i regjistrimit të të dhënave në Regjistër, por jo momenti i lëshimit të certifikatave të ndryshme.

Qasja që mund të jetë e suksesshme në Kosovë ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit aktual. Kjo do të zvogëlonte ngarkesat administrative për qytetarët kur autoritetet shtetërore dhe organet qeverisëse kërkojnë nga ata të dorëzojnë certifikata në letër apo kopje të dokumenteve të identifikimit.

Problemi kryesor

Disa nga arsyet kryesore që kanë iniciuar hartimin e këtij Koncept Dokumenti ndërlidhen me ndryshimet dhe dinamikat që kanë shfaqur këto vitet e fundit të dhënat që regjistrohen në gjendjen civile. Për shkak të dinamikës së zhvillimit teknologjik, është e rëndësishme vitale të krijohet infrastruktura e duhur për shpërndarje dhe shkëmbim të të dhënave të gjendjes civile me akterët dhe insitucionet relevante.

Regjistrimi i faktit të lindjes

Ligji aktual për gjendjen civile ka shfaqur disa probleme në pjesën e regjistrimit të faktit të lindjes. Një ndër problemet kryesore në regjistrim të faktit të lindjes është mungesa e trajtimit të raportimit nga insitucionet shëndetësore për lindjen si fakt. Ndonëse ligji aktual obligon insitucionet shëndetësore që të raportojnë për faktin e lindjes, kur ARC si insitucion pranon informatën, sipas ligjit aktual, nuk krijohet akti i lindjes, pra informata e pranuar nuk ka trajtim të mëtutjeshëm. Raportimi sipas analizës së bërë gjithashtu ka shfaqur problem edhe në mënyrën që janë raportuar të dhënat. Shumicën e rasteve të dhënat e pranuar kanë qenë të mangëta, madje ka pas mungesë edhe të 21 mijën bazike. Në raste të caktuara, në këto raportime mungojnë të dhënat identifikuese të prindërve, sidomos të nënës, duke shkaktuar probleme në procedurën e regjistrimit të lindjes nga organet kompetente. Ligji aktual obligon që të raportohet në baza periodike, por as përmes ligjit, e as përmes akteve nënligjore nuk ka paraparë një formë unike e cila do të përdorej për raportim nga insitucionet shëndetësore. Kjo ka shfaqur probleme edhe tek mbledhja e statistikave vitale nga organet kompetente.

Ligji për Familjen parashikon që fëmijës t'i jepet një identitet pas lindjes. Regjistrimi i faktit të lindjes në secilin rast parashihet edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në praktikë, ka situata të atilla kur nëna njihet por është pa identitet ligjor, duke pamundësuar kështu regjistrimin e fëmijës. Edhe pse babai biologjik i fëmijës posedon dokumentet e identitetit, regjistrimi i lindjes në nivel administrativ nuk procedohet tutje për shkak të mungesës së të dhënave të identitetit të nënës, pavarësisht nga vendi i lindjes (spital/shtëpi). Për më tepër, praktika tregon se këto raste nuk procedohen as nga gjykatat për shkak se ndërmjet prindërve nuk ka kontest, duke e lënë fëmijën të paregjistruar.

Gjithashtu, problem tek regjistrimi i faktit të lindjes është edhe mungesa e dokumenteve të identifikimit për disa kategori të personave, prandaj, është thelbësore që personat nën mbrojtjen ndërkombëtare (pa shtetësi, refugjatë, nën mbrojtje plotësuese dhe të përkohshme) të përfshihen në të gjitha ndryshimet relevante.

Në regjistrim të faktit të lindjes, pavarësisht vëmendjes dhe dinamikës që i është kushtuar në përgjithësi në shtetet e tjera çështjes “i lindur i vdekur”, ligji aktual i gjendjes civile në Republikën e Kosovës nuk trajton këtë kategori. Çështja problematike është se ndonëse ka numër të madh të këtyre lindjeve, nuk ka kritere të standardizuara për regjistrimin e fëmijës që lind i vdekur.

Regjistrimi i faktit të vdekjes

Edhe tek regjistrimi i faktit të vdekjes në analizën e bërë janë identifikuar disa probleme në zbatim. Si fillim, në praktikë janë hasur një numër i rasteve kur personat paraqiten për regjistrim të vdekjes të anëtarit të familjes, por u mungon raporti mjekësor. Ndonëse ligji aktual shprehimisht kërkon që për regjistrim të vdekjes duhet të ketë raport mjekësor, në praktikë mungesa e qartësisë ligjore të dispozitave përcjellëse ka shfaqur një sërë problemesh.

Njësoj si tek regjistrimi i aktit të lindjes, edhe tek vdekja, ndonëse institucionet janë të obliguara të raportojnë vdekjen e një personi kur ajo vdekje ka ndodhur në institucionin e tyre, problematike është mungesa e trajtimit të raportimit nga institucionet kompetente për raportim të vdekjes, nga ana e ARC-së dhe ZGJC-ve. Pra, njësoj si tek regjistrimi i faktit të lindjes, as vdekja nuk mund të regjistrohet pa deklaram të anëtarëve të familjes.

Duke marrë parasysh që Kosova ofron strehim për kategori të ndryshme të personave, përfshirë ata nën mbrojtjen ndërkombëtare, është thelbësore përfshirja e një prej këtyre kategorive, e që do të reflektonte mbi procedurat e kërkuara për regjistrimin e fakteve të vdekjes për personat të cilëve i është dhënë statusi për mbrojtje ndërkombëtare. Gjithashtu, si për qytetarët e Kosovës, duhet të parashikohet procedura e varrimit si dhe arazhmanet të tjera përkatëse.

Regjistrimi i mëvonshëm dhe reregjistrimi

Në ligjin aktual parashihet se kur lindja dhe vdekja nuk janë regjistruar brenda afatit të përcaktuar në ligj, atëherë regjistrimi i mëvonshëm mund të bëhet me vendim të Zyrës së Gjendjes Civile. Zbatimi i regjistrimit të mëvonshëm është i rregulluar edhe me akte nënligjore, mirëpo kriteret për regjistrim të mëvonshëm nuk janë të përcaktuara si duhet dhe janë shumë të gjera. Për më tepër, regjistrimi i mëvonshëm krijon implikime edhe tek shtetësia, andaj, problem është edhe fakti që vendimi për regjistrim të mëvonshëm është vendim që merret nga zyrat e gjendjes civile.

Çdo regjistrim i lindjeve, vdekjeve dhe/ose martesave, i cili paraprakisht është regjistruar në librat e regjistrimit të gjendjes civile në komunë reregjistrohet nëse aplikanti është në gjendje të vërtetojë regjistrimin paraprak në bazë të dokumenteve të lëshuara nga regjistri themeltar i gjendjes civile dhe/ose regjistrit qendror të gjendjes civile apo dokumentet e lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, të cilat përmbajnë regjistrimin origjinal dhe të cilat më vonë kanë humbur dhe/ose janë shkatërruar. Reregjistrimi vlerësohet se për shkak të situatës është e nevojshme që të parashihet si mundësi, por njësoj si tek regjistrimi i mëvonshëm, fakti që vendimi merret nga zyrat e gjendjes civile duhet të rishikohet.

Bashkëjetesa

Ligji për Familjen njih krijimin e të drejtave dhe detyrimeve nga bashkësia faktike e dy (2) personave (bashkëjetesa). Mirëpo kjo kategori nuk regjistrohet në gjendjen civile sipas Ligjit për Gjendjen Civile në fuqi. Shumica e shteteve të Bashkimit Evropian regjistrojnë bashkëjetesën e cila krijon të drejta të njëjta apo ekuivalente me martesën, kjo në përputhje me adatet e përcaktuara në Ligjin përkatës për Familjen.

Ndërrimi dhe korrigjimi i të dhënave

Gjendja civile i ka disa përbërës: emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia vendbanimi e të ngjashme. Ky ligj aktual nuk e parasheh mundësinë e ndërrimit të të dhënave, por parasheh vetëm për korrigjim. Përrjashtim nga ky rregull, bën vetëm emri personal, i cili rregullohet me ligj të veçantë.

Ligji për Gjendjen Civile njeh të drejtën e personit për të ndryshuar gjininë e tij/saj, megjithatë, nuk siguron mekanizëm ligjor për ta ndryshuar atë. Synimi i ligjvënësit është shumë i qartë për sa i përket përcaktimit të së drejtës për të ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, përfshirë gjininë. Sidoqoftë, mungesa e ligjeve specifike nuk arrin të sigurojë mekanizmin përmes së cilit një person mund të ushtrojë këtë të drejtë dhe të ndryshojë të dhënat në gjendjen civile.

Pavarësisht mungesës së bazës ligjore dhe dispozitave jo shumë të qarta ligjore, ekzistojnë disa vendime të Gjykatave vendore në lidhje me ndryshimin e njëres nga komponentat e gjendjes civile, gjinisë.

Në gusht 2019, Gjykata e Apelit ka vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, e cila kishte afirmuar të drejtën e një aplikanti që i ishte nënshtruar një operacioni të ndryshimit të gjinisë, për të ndryshuar emrin dhe shënuesin gjinor në përputhje me identitetin e tyre gjinor. Në dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë në mënyrë të ngjashme njohu të drejtën për të ndryshuar emrin dhe shënuesin gjinor për një person i cili kishte filluar terapinë hormonale, por nuk i ishte nënshtruar një operacioni për ndryshimin e gjinisë. Në vendimin e gjykatës thuhet se vendimet e Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative brenda Komunës së Gjakovës, bazuar në rekomandimin e Agjencisë së Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC), “anulohen si të paligjshme” dhe obligon institucionet përkatëse që të korrigojnë zyrtarisht emrin e aplikantit dhe shënuesin e seksit.

Rrjedhimisht, në të dy rastet gjykata ka afirmuar të drejtën e personit për të ndryshuar emrin dhe shënuesin gjinor, të drejta të cilat garantohen edhe me Ligjin për Gjendjen Civile. Në të dy rastet, gjykatat udhëzuan ARC-në që të ndiqte procedurat për të ndryshuar emrin e një personi siç përshkruhet në Ligjin për Emrin Personal. Megjithatë, në të dy rastet gjykatat nuk kanë përfunduar bazën konkrete të procedurave administrative mbi të cilat organet përkatëse duhet të bëjnë ndryshimet e shënuesit gjinor.

Vlefshmëria juridike e të dhënave (elektronike) të gjendjes civile në sistem të Gjendjes Civile

Numri i certifikatave të cilat lëshon gjendja civile brenda një viti janë përafërsisht 2 milion. Tendencat e vendeve fqinje, por edhe vendeve të zhvilluara është përqendruar drejt digjitalizimit të informacionit - andaj një numër kaq i madh i kërkesave të lëshuara për certifikata të gjendjes civile ka shfaqur problematikat e veta. Si fillim, një numër kaq i madh i certifikatave është barrë financiare dhe administrative për qytetarët, si dhe ka impakt negativ në ambient. Gjithashtu problem është edhe fakti që shumë institucione ju caktojnë afat vlefshmërie dokumenteve të lëshuara nga gjendje civile, pavarësisht se Ligji për Gjendjen Civile nuk parasheh një gjë të tillë.

Organizimi i zyrave të gjendjes civile

Nuk ekziston një bazë apo përcaktim ligjor mbi të cilën hapen zyrat e gjendjes civile dhe kjo ka shkaktuar që të ketë numër të madh të zyreve të gjendjes civile nëpër komuna. Me zhvillimet e reja teknologjike dhe trendeve të lëvizjes së popullsisë, një numër kaq i madh i zyrave të gjendjes

civile vlerësohet se nuk është e nevojshme, dhe rrjedhimisht do të duhet të ketë një racionalizim të këtyre zyreve.

Gjithashtu organizimi i gjendjes civile në shërbimin e jashtëm diplomatik të Republikës së Kosovës duhet të rishikohet me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve konsullor që ofrojnë shërbime të gjendjes civile.

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Krijimi i vështirësuar i të dhënave të gjendjes civile.
	Qasje e komplikuar për qytetarët në të dhënat e gjendjes civile.
Problemi kryesor	Në bazë të analizës së gjendjes aktuale, çështja kryesore është avancimi i shpërndarjes dhe shkëmbimi të të dhënave dhe shërbimeve të gjendjes civile, si dhe harmonizimi i legjislacionit aktual me <i>acqui</i> të BE-së, si dhe përshtatja me dinamikat dhe trendet e reja në fushën e gjendjes civile.
Shkaqet	Mungesa e ndërlidhjeve automatike të sistemeve për shkëmbim të të dhënave ndërmjet institucioneve shëndetësore dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil / Zyra e Gjendjes Civile.
	Teknologjitë e bazuara në letër ende vazhdojnë të aplikohen dhe nuk ka mundësi për zhvillimin e shërbimeve elektronike.
	Nuk ka status të qartë ligjor të dhënave në letër dhe regjistër.

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu tregon nëse palët e interesuara janë prekur nga shkaqet dhe/apo efektet e problemit, të përkufizuar më lartë. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si janë prekur këto palë të identifikuar në kolonën e parë. Kapitulli 5, tregon se a janë konsultuar këto palë.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Agjencia e Regjistrimit Civil	Zbatues i ligjit Koordinues në nivel qendror i gjendjes civile	Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes lokale. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrat e gjendjes civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shërbimi i gjendjes civile është i organizuar në nivelin qendror të shërbimit të gjendjes civile, respektivisht Agjencinë për Regjistrimin Civil.
Zyrat e Gjendjes Civile	Zbatues i gjendjes civile në nivel lokal	Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes lokale. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrat e gjendjes civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në nivelin lokal të shërbimit të gjendjes civile, respektivisht Zyrat e gjendjes civile.
Përfaqësitë konsullore dhe diplomatike të Kosovës.	Zbatues i gjendjes civile në shtete të jashtme.	Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes lokale. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrat e gjendjes civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Kosovës.

KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT

Qëllimi

Qëllimi kryesor është të zbatohet teknologjia pa letra, të vendosen rregullat që të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga zyrtari i shërbimit të gjendjes civile në mënyrën dhe formën e përcaktuar me Ligjin për Gjendjen Civile dhe aktet nënligjore që dalin në zbatimin e tij.

Objektivat

Objektivat e propozimit ndahen në kategori kryesore:

1. Të sqarojnë kuptimin dhe përkufizimin e Regjistrit Qendror të Gjendjes Civile (RQGJC);
2. Të përcaktohen parimet dhe rregulloret e mbledhjes së të dhënave, si dhe për shkëmbimin i të dhënave të gjendjes civile me palët e treta;
3. Të plotësohet ligji me nene/dispozita që përcaktojnë momentin kur të dhënat nga RQGJC duhet të njihen si të sakta dhe të plota.

Vendosja e parimeve për forcimin e sigurisë publike dhe avancimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe publikun.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Objektivi strategjik 2.4.5.	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025.
Objektivi specifik: Avancimi i kornizës ligjore në fushën e gjendjes civile.	Sipas këtij koncept-dokumenti.

KAPITULLI 3: OPSIONET

Duke u bazuar në identifikimin e problemeve, përfshirë shkaqet dhe pasojat, në kuadër të këtij Koncept Dokumenti janë trajtuar dhe elaboruar opsionet e ndryshme që synojnë adresimin e mangësive që janë identifikuar në analizën e situatës dhe me të cilat mund të procedohet në fushën e gjendjes civile.

Ky koncept dokument trajton opsionet si në vijim:

1. Opsioni *status quo* (pa asnjë ndryshim) sipas të cilit situata aktuale do të vazhdoj së ekzistuari;
2. Opsioni i dytë është opsioni me ndryshime për përmirësim të zbatimit të kornizës aktuale ligjore por pa ndryshime legjislative, i cili tenton të adresojë disa nga problematikat që janë identifikuar por e ka të pamundur të ofrojë bazë të re ligjore; dhe
3. Opsioni i tretë është ai me ndryshime legjislative, konkretisht me hartim të ligjit të ri i cili parasheh adresimin e të gjitha problemeve të shtjelluara dhe përafrimin e legjislacionit vendor me *acqui* të BE-së.

Kapitulli 3.1: Opsioni status quo (nuk ka ndryshim)

Opsioni pa ndryshime parasheh vazhdimin e gjendjes ekzistuese. Mos ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Gjendjen Civile do të ruante gjendjen *status quo* dhe nuk do të ketë mundësi për zvogëlimin e sasisë e dokumenteve që kërkohen nga qytetarët dhe sektori publik. Në të njëjtën kohë, qytetarët nuk do të përfitonin nga shërbimet më të mira dhe mundësitë për të marrë të dhëna personale të nevojshme për qëllime administrative përmes zgjidhjeve të zbatuara të TI-së. Barra administrative mbetet e njëjtë.

Nëse korniza ligjore ekzistuese ruan dispozitat për përdorimin e mëtejshëm të teknologjive të bazuara në letër, nuk do të ketë mundësi për të harmonizuar plotësisht aktet ligjore me legjislacionin e BE-së.

Kapitulli 3.2: Rishikimi i politikave ekzistuese

Opsioni i dytë shqyrton mundësinë e përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime konkrete legjislative. Ky opsion, ngjashëm do të linte në fuqi Ligjin aktual si shtyllë bazike e fushës së gjendjes civile, me disa ndryshime të vogla sistematike që synon përmirësimin e zbatimit të normave aktuale.

Siç është elaboruar edhe më lartë në kuadër të këtij Koncept Dokumenti, korniza ligjore që rregullon fushën gjendjes civile nuk përfshinë në vete ndryshimet dhe dinamikën e zhvillimeve teknologjike lidhur me të dhënat e gjendjes civile. Gjithsesi, nëse miratohet ky opsion, atëherë do të mund të arrihet në ngritje të kapaciteteve profesionale në fushën e zbatimit të legjislacionit për gjendjen civile. Kjo nënkupton rritjen e numrit të të punësuarve sidomos në vendimmarrje. Opsioni për përmirësimin e zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative që e propozon ky koncept-dokument sygjeron një numër të masave në funksion të zbatimit të Ligjit për Gjendjen Civile dhe akteve tjera nënligjore dhe që ndërlidhen kryesisht me aktivitete si në vijim:

- Rritjen e kapaciteteve profesionale;
- Fuqizimin e kapaciteteve profesionale për të zbatuar Ligjin e Gjendjes Civile;
- Digjitalizimin e shërbimeve me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe ndërlidhjen e bazave të ndryshme të të dhënave që do të rezultoj edhe me gjenerimin më të mirë të të dhënave statistikore me qëllim të hartimit të politikave në fushën që lidhet me gjendjen civile.

Masat e propozuara me siguri që do kenë edhe implikime financiare. Gjithsesi, duke vlerësuar se as ky opsion nuk do t'i shërbente si duhet përmirësimit të situatës dhe zbrazëtirave ligjore të identifikuar, andaj grupi punues nuk e rekomandon këtë opsion.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë - Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit përmes ndryshimeve legjislative (i rekomanduar)

Regjistrimi civil përkufizohet si regjistrim i vazhdueshëm, i përhershëm, i detyrueshëm dhe universal i gjendjes së karakteristikave të ngjarjeve jetësore, të tilla si regjistrimi i lindjes, vdekjes dhe gjedjes martesore. Ky regjistrim shërben që individët të vërtetojnë identitetin, krijojnë të drejtën e tyre për të fituar shtetësi, si dhe mundëson që tu krijojnë të drejtën për tu qasur në një numër të madh shërbimesh.

Politika ekzistuese mund të rishikohet duke plotësuar dhe ndryshuar ligjin aktual. Opsioni i tretë shqyrton mundësinë e ndryshimeve ligjore përmes miratimit të ligjit të ri për gjendjen civile. Mos ndryshimi i bazës ligjore, domethënë vazhdimi i zbatimit të ligjit aktual, do të pamundëson zbatimin e teknologjive që përjashtojnë përdorimin e letrës, ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe publikun, si dhe mundësinë për të harmonizuar aktet ligjore me legjislacionin e BE-së dhe përkufizimet e regjistrave modern.

Hartimi i këtij koncept dokument ka për qëllim të krijojë një mekanizëm ndërinstitucional, që përmes hartimit të Ligjit të ri të krijohet baza ligjore e cila mundëson regjistrimin e të gjitha fakteve natyrore të gjendjes civile siç janë lindja dhe vdekja, në formë zyrtare, përmes raportimeve zyrtare nga institucionet që kanë të drejtë të vërtetojnë faktet natyrore, përmes një forme unike, ku zyrat e gjendjes civile do të evidentojnë këto fakte në regjistrat e gjendjes civile, respektivisht në regjistrin qendror të gjendjes civile, pavarësisht vendbanimit apo vendit të lindjes. Ky ndryshim do të krijojte hapsirë të mjaftueshme që bashkëpunimi dhe ndërlidhja e të dhënave në mes institucioneve relevante të bëhet në mënyrë më efektive, duke e lehtësuar kështu edhe ngarkesën që kanë qytetarët për regjistrim të të dhënave të lindjes dhe vdekjes, pikërisht për shkak se këto të dhëna nuk krijohen *ex officio*.

Ligji i ri për Gjendjen Civile do të krijoj gjithashtu bazën e nevojshme ligjore për të regjistruar “i lindur i vdekur”. Ashtu siç është diskutuar edhe në përkufizim të problemit, ligji aktual nuk trajton këtë dukuri, ndërsa statistikën dhe raportimet tregojnë që kjo dukuri është prezente. Më anë të miratimit të këtij opsioni, do të përcaktohen afatet dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin për dhe nga regjistrimi “i lindur i vdekur”. I lindur i vdekur është vdekja ose humbja e një foshnje para ose gjatë lindjes. Shumica e shteteve të rajonit, por edhe vendet e zhvilluara e kanë krijuar mekanizmat e nevojshëm për të regjistruar këtë element të gjendjes civile.

Ky ndryshim do të ketë impakt negativ sepse Agjencia e Regjistrimit Civil do t’i ketë informatat e plota për çdo person brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe të dhënat do të përpunoheshin më saktë, sepse regjistri qendror i gjendjes do të populloj me të dhëna të sakta.

Ligji i ri gjithashtu do të adresoj edhe ndërrimin dhe korigjimin e të dhënave. Për momentin ndërrimi dhe korigjimi i të dhënave të gjendjes civile është disi jo i qartë, ndërsa mund të ndërrohet vetëm njëra nga komponentat e gjendjes civile, pra emri personal i cili nënkupton emrin dhe mbiemrin. Emri personal për momentin është i rregulluar me Ligj të veçantë, mirëpo me miratim të këtij opsioni, edhe emri personal do të trajtohet nga Ligji për Gjendjen Civile, ndërsa Ligji i cili është në fuqi për emrin personal do të shfuqizohet.

Për më tepër, Ligji për Gjendjen Civile njeh të drejtën e personit për të ndryshuar gjininë e tij/saj, megjithatë, nuk siguron mekanizëm ligjor për ta ndryshuar atë. Për më tepër, edhe ligji për barazinë gjinore gjithashtu siguron garancitë e mëposhtme për të drejtën në identitet dhe barazi gjinore:

Vendet evropiane dhe rajonale bëjnë një dallim të qartë, si në legjislacion ashtu edhe në përdorimin e përditshëm, midis termave "seks" dhe "gjini". Në terma të përgjithshëm, "seksi" i referohet ndryshimeve biologjike midis meshkujve dhe femrave, të tilla si gjenitale dhe dallimet gjenetike. "Gjinia" është më e vështirë të përcaktohet, por mund t’i referohet rolit të një mashkulli ose femre në shoqëri, i njohur si roli gjinor, ose koncepti i një individi për veten, ose identiteti gjinor. Në këto vende, certifikatat e lindjes, kartat e identitetit dhe pasaportat lëshohen në mënyrë tipike nga shteti, dhe kështu në këto dokumente shënohet seksi biologjik si mashkull apo femër. Gjinia nuk shfaqet si karakteristikë në dokumentet personale.

Në Kosovë, megjithatë, në përdorimin e përditshëm këto dy terma i referohen dallimeve biologjike dhe përdoren si sinonime të njëri-tjetrit. Dokumentet personale siç janë certifikatat e lindjes, kartat e identitetit dhe pasaportat listojnë dy terma të ndryshëm, në gjuhën shqipe dhe angleze që kanë kuptime të ndryshme: "gjinia" në shqip dhe "seks" në anglisht. Edhe pse të dy termat kanë kuptime të ndryshme dhe janë renditur si karakteristika të ndryshme personale nga instrumente të ndryshme juridike ndërkombëtare dhe legjislacionit vendor, shënuesi shfaqet i njëjtë në të dy gjuhët si F për "femrën" dhe M për "mashkullin", duke iu referuar dallimeve biologjike midis meshkujve dhe femrave, të tilla si organet gjenitale dhe dallimet gjenetike.

Kjo mospërputhje, është e dukshme edhe në legjislacion edhe pse Ligji për Barazinë Gjinore përcakton dhe bën një dallim të qartë të këtyre termave. Me miratim të këtij Ligji, synohet që të krijohet baza e nevojshme për të krijuar përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë me Ligjet që janë në fuqi, me Vendimet e Gjykatave si me instrumentet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë.

Rrjedhimisht, ligji i ri në raport me gjininë, synon që:

Ligji i ri për Gjendjen Civile të rregulloj çështjet si në vijim, që garantojnë njohjen dhe gëzimin e të drejtës për identitet gjinor, përmes:

- Parashikimit të procedurave për ndryshimin e të dhënave të gjendjes civile siç janë emri dhe gjinia;
- Parashikimit të procedurave për njohjen e vendimeve të huaja për ndryshimin e të dhënave të gjendjes civile për qytetarët dhe personat rezident;
- Procedura e ndërrimit të treguesit gjinor do të jetë e qartë, e shpejtë dhe lehtë e qasshme.

Këto ndryshime do të jenë në përputhje me:

- Legjislacionin e BE-së dhe harmonizimin e këtyre neneve/dispozitave me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi për të garantuar njohjen e të drejtës për identitet gjinor dhe procedurat për ndryshimin e të dhënave të gjendjes civile që mundësojnë realizimin e kësaj të drejtë për qytetarët e Kosovës.

Përmes Ligjit të ri, synohet gjithashtu që të krijohet mundësia që institucionet dhe qytetarët të përdorin sa më shumë të dhënat në formë elektronike përmes regjistrimit qendror të Agjencisë për Regjistrim Civil, duke e zvogëluar kështu në masë të konsiderueshme nevojën për lëshim të dokumenteve të gjendjes civile në letër. Përmes kësaj, të dhënat elektronike do të marrin statusin e duhur ligjor dhe do të përdoren lehtësisht nga qytetarët kur këto të dhëna u kërkohen nga institucionet e tjera brenda territorit të Kosovës.

Duhet theksuar se trendet aktuale të zhvillimit të teknologjisë informative si pjesë e pashmangshme e ndryshimeve që pastaj reflektojnë edhe në aspektin ligjor të të dhënave, kërkojnë që Ligji i ri përkitazi me trendet aktuale të zhvillimit të teknologjisë informative, apo mundësi të reja teknike. Lidhur me këtë pastaj është parë e nevojshme që përmes Ligjit të ri të krijohet hapësira dhe baza e nevojshme ligjore që të rregullohet organizimi i zyrave të gjendjes civile, respektivisht zyrave të gjendjes civile nëpër fshatra, brenda një Komune, pasi që nga praktika është vërejtur se ka nevojë për rivlerësim të numrit të këtyre zyrave.

Gjithashtu organizimi i gjendjes civile në shërbimin e jashtëm, apo në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, të parashihet me Ligjin e ri, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe ngritjes profesionale, për zyrtarët që ofrojnë këto shërbime.

Me hartim të Ligjit të ri për Gjendjen Civile, do të jetë e mundur të zvogëlohet numri i dokumenteve në letër, të zbatohet një regjistër modern i popullsisë, të krijohen shërbimet elektronike për qytetarët dhe bizneset, dhe të zvogëlohen ngarkesat administrative për qytetarët duke ofruar shërbime të ndryshme administrative nga autoritetet shtetërore dhe organeve.

Me hyrjen në fuqi të një ligji të ri me ndryshimet e propozuara, Agjencia e Regjistrimit Civil duhet të ndryshojë zgjidhjet teknologjike të Sistemit aktual të Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe të përgatisë aplikacione të reja të shërbimit elektronik për qytetarët dhe sektorin publik. Ligji i ri do të harmonizohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil, si dhe do të shfuqizoj Ligjin për Emrin Personal, të cilin do ta trajtoj si pjesë përbërëse të Ligjit për Gjendjen Civile.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Ndikimet e pritshme janë identifikuar dhe elaboruar në kuadër të këtij kapitulli, duke u bazuar në opsionin i cili ka gjetur mbështetje nga grupi punues, përkatsisht opsioni i ligjit të ri të Ligjit për Gjendjen Civile.

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Ligji i ri i Gjendjes Civile do të ketë ndikim të vogël pozitiv ekonomik, kryesisht në lehtësim të barrës administrative për qytetarët.
Ndikimet shoqërore	Nuk planifikohen ndikime të mëdha shoqërore gjithsesi, ndryshimet e vogla do të ketë ndikim pozitiv shoqëror.
Ndikimet mjedisore	Në përgjithësi, masat e propozuara nuk do të kenë ndikim mjedisor, me përjashtim të sistemit që është i bazuar në teknologji, i cili do të ketë ndikim pozitiv për nga konsumi më i vogël i letres, ndërsa sistemi i centralizuar do të kontribuojë në uljen e numrit të aplikantëve fizikisht dhe së këndejmi do të ketë më pak udhëtime.
Ndikimet në të drejtat themelore	<p>Masat e propozuara do të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë në garantimin e të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ndërkombëtare.</p> <p>Me ndryshimin e Ligjit aktual për Gjendjen Civile do të krijohet baza e duhur ligjore përmes së cilës qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë mundësi të bëjnë ndryshime të komponentës gjinore të gjendjes civile.</p>
Ndikimi gjinor	Masat e propozuara do të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë në barazinë gjinore të trajtimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.
Ndikimet e barazisë sociale	Masat e propozuara në koncept dokument nuk kanë ndikim të drejtëpërdrejtë.
Ndikimet tek të rinjtë	Masat e propozuara në koncept dokument nuk kanë ndikim të drejtëpërdrejtë te të rinjtë.

Ndikimet në ngarkesën administrative	Masat e propozuara në këtë koncept dokument nuk pritet të ketë ndikim në ngarkesën administrative.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi Punues ka pasur në përbërjen e tij përfaqësim të duhur për sigurimin e informatave të nevojshme për hartimin e këtij Koncept Dokumenti. Puna është udhëhequr nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, të cilët ka siguruar informatat e përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme. Në anën tjetër, analizat specifike për Koncept Dokument janë siguruar nga të gjithë anëtarët e Grupit Punues.

Andaj, mund të konfirmohet që nuk ka pasur probleme të theksuara dhe sfida në mbledhjen e këtyre informatave.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Kur të miratohet ky ligj, Ministria e Punëve të Brendshme do të organizojë një konferencë për shtyp për të njoftuar akterët lidhur me këtë çështje, për të shpërndarë njoftime për të gjitha ZKGC-të. Mesazhi kryesor do të jetë informimi i qytetarëve dhe publikut rreth mundësive të reja të ofruara nga teknologjitë e zbatuara që përjashtojnë përdorimin e letrës, dhe përdorimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe sektorin publik.

Procesi i konsultimit publik do të bëhet sipas Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Udhëzimeve për Procesin e Konsultimit Publik (Shtator 2011 dhe Versioni i Konsulencës nga viti 2017), ku pjesëmarrësit e përmendur më lart kanë dorëzuar draftin origjinal të këtij koncept dokumenti. Përveç kësaj, u konsultuan ekspertët e BE-së që punonin në projektin e binjakëzimit "Mbështetje për regjistrimin civil dhe sigurinë e dokumenteve" në Kosovë. Pas këtyre konsultimeve u konstatua se ndryshimet e mësipërme janë më se të nevojshme. Para proceseve për miratim nga Qeveria, ky koncept dokument do të dorëzohet për konsultime paraprake ndërministrare dhe konsultime publike përmes platformës për konsultime publike.

Gjatë hartimit të këtij Koncept Dokumenti janë mbajtur disa takime të grupit punues, gjatë të cilave është diskutuar qëllimi dhe përmbajtja e këtij Koncept Dokumenti. Janë trajtuar problemet që janë shfaqur në zbatim të ligjit aktual, si dhe rekomandime të institucioneve të përfshira në zbatim të ligjit.

Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë, Koncept Dokumenti është dërguar për konsultime paraprake me datë 24.11.2021.

Ky Koncept Dokument gjithashtu është publikuar në platformën e konsultave publike me datën 30.11.2021 deri me datë 21.12.2021.

Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon: Konsultimin e palëve të interesuara për përmbajtjen e Koncept Dokumentit; Transparencën gjatë hartimit të Koncept Dokumentit për të Huajt.						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjitha palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara	Takime të grupit punues	Takim me prezencë fizike	Shtator 2021	/	Erdon Arifaj, ARC, MPB
Konsultim paraprak me shkrim	Institucionet e	Komunikimi i Brendshëm	Përmes postës zyrtare elektronike	24.11.2021 deri më 26.11.2021	/	Meliza Qorraj, DL, MPB

	Republikës së Kosovës					
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Përmes postës zyrtare elektronike	30.11.2021 deri më 21.12.2021	/	Erdon Arifaj, ARC, MPB

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Në kuadër të këtij kapitulli janë paraqitur planet për zbatimin e opsioneve dhe një analizë krahasimore në mes të opsioneve përmes së cilave synohet të justifikohet përzgjedhja e opsionit të preferuar i cili në mënyrë më efikase do të adresoj problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e identifikuara.

Përmbledhje e opsioneve

Veçoritë kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Veçoritë kryesore të opsionit.	Situata mbetet e pandryshuar, përdoren ende teknologjitë e bazuara në letër, nuk ka mundësi për të ofruar shërbime elektronike për qytetarët dhe publikun, nuk ka mundësi për të harmonizuar aktet ligjore dhe përkufizimet e regjistrave modern me legjislacionin e BE-së.	Me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit aktual: duhet të zbatohet një përkufizim modern i sistemit të regjistrave, duhet të zhvillohen shërbimet elektronike për qytetarët dhe publikun, duhet të legalizohet statusi ligjor i të dhënave të regjistratit.	Nëse baza ligjore dhe politika ekzistuese mbetet, atëherë është e pamundur të ofrohen shërbimet elektronike për qytetarët dhe publikun, nuk ka mundësi për të harmonizuar aktet ligjore, përkufizimet e regjistrave modern me legjislacionin e BE-së dhe.
Segmenti i popullsisë / sektori / rajoni i synuar.	Qytetarët dhe sektori publik i Republikës së Kosovës të cilët do të jenë shfrytëzues të teknologjive të bazuara në letër që do të shpenzojnë më shumë para për marrjen e certifikatave të panevojshme dhe paraqitjen e kopjeve të dokumenteve tek autoritetet	Qytetarët dhe publiku i Republikës së Kosovës do të kenë mundësinë të përdorin shërbimet elektronike bazuar në teknologjitë moderne të TI-së. Shuma e dokumenteve të letrës duhet të zvogëlohet.	Qytetarët dhe publiku i Republikës së Kosovës të cilët do të jenë shfrytëzues të teknologjive të bazuara në letër që do të shpenzojnë më shumë para për marrjen e certifikatave të panevojshme dhe paraqitjen e kopjeve të dokumenteve tek autoritetet

	shtetërore dhe organet qeverisëse.		shtetërore dhe organet qeverisëse.
Veçoritë e zbatimit - kush është përgjegjës - një departament qeveritar (i cili), sektori privat, qytetarët.	Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin.	Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin.	Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin.
Administrimi ose zbatimi i programit ose i shërbimit.	Ministria e Punëve të Brendshme e kryen zbatimin dhe mbikëqyrjen.	Ministria e Punëve të Brendshme e kryen zbatimin dhe mbikëqyrjen.	Ministria e Punëve të Brendshme e kryen zbatimin dhe mbikëqyrjen.
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese, zbatimi dhe ndëshkimet.	Nuk ka ndryshime.	Ndryshimi ose plotësimi i Ligjit 04L-003 për Gjendjen Civile dhe ndryshimi i akteve nënligjore përkatëse.	Nuk ka ndryshime.
Nxitje ekonomike apo nuk ka nxitje ekonomike - subvencione apo taksa.	Buxheti i aprovuar.	Buxheti i aprovuar për 2018 dhe 2019.	Buxheti i aprovuar.
Fushat e edukimit dhe komunikimit.	Asnjë	Konferenca për shtyp, udhëzimet e shërbimeve elektronike	Nuk ka asnjë.
Udhëzimet dhe kodet.	Asnjë	Udhëzimet administrative të përmendura më poshtë	Nuk ka asnjë.
Afatet kohore - kur opsioni hyn në fuqi.	Vazhdon	T2 2019	T2 2019

Opsioni i rekomanduar është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04 / L-003 për Gjendjen Civile. Duhet të përgatitet udhëzimi i ri administrativ.

Përfitimet

1. Opsioni 1: Nuk ka përfitime, teknologjitë e bazuara në letër ende përdoren, nuk ka status të qartë ligjor të dhënave në letër dhe regjistër, nuk ka mundësi për zhvillimin e shërbimeve elektronike.

2. Opsioni 2: Me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit aktual, do të zbatohet një kuptim modern i regjistrave dhe do të zhvillohen shërbimet elektronike për qytetarët dhe sektorin publik. Përveç kësaj, ndryshimi i Ligjit aktual, do të harmonizon aktet ligjore të Kosovës me legjislacionin e BE-së.
3. Opsioni 3: Me hartimin e ligjit të ri, Çdo ndryshim në qasjen ekzistuese për zbatimin e ligjit nuk do t'i jep të drejtë qytetarëve të përdorin shërbimet elektronike bazuar në teknologjitë moderne të TI-së. Shuma e dokumenteve të letrës nuk duhet të ulet.

Pasojat negative

1. Opsioni 1: Pasojat e këtij opsioni do të jenë si më poshtë: qytetarët dhe sektori publik do të vazhdojnë të përdorin teknologjitë e bazuara në letër, të përballen me të njëjtat vështirësi në kryerjen e shërbimeve elektronike, nuk ka mundësi për të harmonizuar legjislacionin me legjislacionin e BE-së.
2. Opsion 2: Shpenzimet financiare mund të jenë vetëm pasoja negative. Por duke pasur parasysh faktin se ngarkesa administrative për qytetarët, autoritetet shtetërore dhe organet qeverisëse do të zvogëlohet dhe harmonizimi i akteve ligjore me legjislacionin e BE-së do të jetë i mundshëm, këto shpenzime do të mbulohen përmes rritjes së përdorimit të të dhënave të Regjistrat nga qytetarët të cilët do të përdorin shërbimet elektronike, shpenzimet do të zvogëlohen për institucionet qeveritare në administrimin e dokumenteve në letër dhe me krijimin e sistemit fleksibël të tarifave / taksave nga përdorimi i të dhënave.
3. Opsioni 3: Çdo ndryshim në qasjen ekzistuese për zbatimin e ligjit nuk do t'i jepte të drejtë qytetarëve të përdorin shërbimet elektronike bazuar në teknologjitë moderne të TI. Shuma e dokumenteve në letër nuk duhet të ulet, dhe në të njëjtën kohë do të ketë vështirësi në harmonizimin e akteve ligjore me legjislacionin e BE-së.

Opsioni 1: Nëse ligji aktual është ende në fuqi, do të pamundëson krijimin e një kuptimi modern të sistemit të regjistrave, ofrimin e shërbimeve elektronike dhe harmonizimin e këtij ligji me legjislacionin e BE-së.

Opsioni 2: Nëse ligji aktual ndryshohet dhe plotësohet, kuptimi modern i sistemeve të regjistrave do të zbatohet, mundësia për shërbimet elektronike do të realizohet, ngarkesa administrative për qytetarët dhe publikun do të zvogëlohet duke i bërë shërbimet dhe informacionet në dispozicion për ata. Përveç kësaj, gjatë rishikimit të ligjit aktual, dispozitat e këtij ligji do të harmonizohen me legjislacionin e BE-së.

Opsioni 3: Ndryshimi në qasjen ekzistuese të ligjit nuk do të lejon qytetarët që të përdorin shërbimet e bazuara në teknologjinë modernë të IT-së. Kjo do të kontribuon në vazhdimin e vështirësive për harmonizimin e akteve ligjore me ato të BE-së.

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Ky koncept dokument do të paraprijë në ndryshimin e kornizës ligjore aktuale. Ligji i ndryshuar do të krijojë një mundësi për të zvogëluar ngarkesën administrative për qytetarët dhe publikun gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të dokumenteve tek autoritetet shtetërore dhe organet qeverisëse, për të zbatuar teknologjitë moderne për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve elektronike. Përveç kësaj, gjatë rishikimit të ligjit aktual, dispozitat e këtij ligji do të harmonizohen me legjislacionin e BE-së. Ministria e Punëve të Brendshme vazhdon të jetë autoriteti që mbikëqyr ARC-në, i cili mban Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile.

Pas shqyrtimit të të gjitha opsioneve, si dhe pasojave negative dhe përfitimeve të mundshme të opsioneve, propozimi është që të miratohet Opsioni 3 si alternativë më e favorshme.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	X		U	U	U
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X	U	U	U
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X	U	U	U
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X	U	U	U
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X	U	U	U
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X	U	U	U
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X	U	U	U
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		X	U	U	U
	A do të krijohen biznese të reja?	X		U	U	U
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?	X		U	U	U
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		X	U	U	U
Tregtia	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X	U	U	U
	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X	U	U	U

¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

[Koncept Dokumenti për Gjendjen Civile]

Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X	U	U	U
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X	U	U	U
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X	U	U	U
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X	U	U	U
	A do të rriten investimet nga diaspora?	X		U	U	U
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X	U	U	U
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	X		U	U	U
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?	X		U	U	U
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		X	U	U	U
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		X	U	U	U
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		X	U	U	U
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		X	U	U	U
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	X		U	U	U
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X	U	U	U

[Koncept Dokumenti për Gjendjen Civile]

	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X	U	U	U
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X	U	U	U
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X	U	U	U
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	X		U	U	U
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		X	U	U	U
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	X		U	U	U
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		X	U	U	U

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	X		U	U	U
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X	U	U	U
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?	X		U	U	U
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		X	U	U	U
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	X		U	U	U
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X	U	U	U
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		X	U	U	U
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		X	U	U	U
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X	U	U	U
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	X		U	U	U
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?	X		U	U	U
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X	U	U	U

² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X	U	U	U
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?	X		U	U	U
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	X		U	U	U
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	X		U	U	U
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?	X		U	U	U
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?	X		U	U	U
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?	X		U	U	U
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X	U	U	U
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X	U	U	U
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X	U	U	U
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		X	U	U	U
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X		U	U	U
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X	U	U	U

	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X	U	U	U
Shëndeti dhe siguria publike ³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X	U	U	U
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X	U	U	U
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X	U	U	U
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X	U	U	U
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X	U	U	U
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X	U	U	U
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X	U	U	U
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		X	U	U	U

³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

[Koncept Dokumenti për Gjendjen Civile]

Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	X		U	U	U
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	X		U	U	U
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?	X		U	U	U
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	X		U	U	U
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?	X		U	U	U

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X	U	U	U
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X	U	U	U
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X	U	U	U
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X	U	U	U
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X	U	U	U
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X	U	U	U
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X	U	U	U
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		X	U	U	U
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X	U	U	U
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		X	U	U	U
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		X	U	U	U

	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		X	U	U	U
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		X	U	U	U
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		X	U	U	U
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		X	U	U	U
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		X	U	U	U
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		X	U	U	U
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		X	U	U	U
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		X	U	U	U
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X	U	U	U
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X	U	U	U
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X	U	U	U
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		X	U	U	U

	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X	U	U	U
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X	U	U	U
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X	U	U	U
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X	U	U	U
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X	U	U	U

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	X		U	U	U
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?	X		U	U	U

[Koncept Dokumenti për Gjendjen Civile]

Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	X		U	U	U
	A janë të drejtat e individit për qasje, korigjim dhe kundërshtim të garantuara?	X		U	U	U
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	X		U	U	U
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X	U	U	U
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?	X		U	U	U
Trajtimi i barabartë ⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	X		U	U	U
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?	X		U	U	U
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X	U	U	U
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsion në të drejtat e fëmijëve?	X		U	U	U
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara?		X	U	U	U
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime	X		U	U	U

⁴ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*

[Koncept Dokumenti për Gjendjen Civile]

	(transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?					
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?	X		U	U	U
	A ndikohet qasja në drejtësi?	X		U	U	U